



Breaking News:

Raporti i ngjarjeve, 14 tetor 2025

⏏ ⏪ ⏩



14/10/2025

# Pogradec/Arrestohen Dy 16-Vjeçarë.Që Qëlluan Me Armë Zjarri Në Drejtim Të Banesës Së Një 42-Vjeçari

Pogradec

Qëlluan me armë zjarri në drejtim të banesës së një 42-vjeçari, në Pogradec, Policia identifikon dhe arreston dy 16-vjeçarë.

Policia gjen armën e zjarrit kallashnikov që ata e mbanin të fshehur në varrezat e qytetit, municion luftarak dhe një dorezë metalike.

Njëri nga 16-vjeçarët, i proceduar penalisht më parë, për plagosje me thikë.

Në vijim të punës së pandërprerë për zbardhjen e ngjarjeve të ndodhura më parë, falë edhe bashkëpunimit me qytetarët, shërbimet e Komisariatit të Policisë Pogradec kanë siguruar informacion për dy shtetas të mitur që mbanin armë zjarri dhe dyshohet se kishin qëlluar në drejtim të një banese, në muajin maj 2025, kanë organizuar punën për dokumentimin ligjor të këtij rasti.

Mbi bazën e këtyre informacioneve, specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Pogradec, në bashkëpunim me shërbimet e Patrullës së Përgjithshme, kapën dhe vunë në pranga shtetasit M. K. dhe J. H., të dy 16 vjeç, banues në Pogradec.

Gjatë kontrollit në banesën e shtetasit M. K., në lagjen nr. 1, u gjetën 1 dorezë metalike (përforcues grushti), një sasi municioni luftarak dhe një gëzhgjë arme zjarri model 56.

Nga veprimet hetimore dyshohet se këta shtetas posedonin një armë zjarri automatik, të cilën e mbanin të fshehur në një varr në varrezat e qytetit të Pogradecit. Gjithashtu, nga hetimet u bë e mundur zbardhja dhe dokumentimi i ngjarjes së ndodhur më datë 11.05.2025, në lagjen nr. 1, Pogradec, ku është qëlluar me armë zjarri në drejtim të banesës së një 42-vjeçari.


Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit", "Dhunimi i varreve", të kryera në bashkëpunim, dhe "Mbajtja pa leje e armëve të ftohta".

#angazhimpërkushtimsakrificë

#tëvendosurkundërkrimit 

#nëçdorskajtëvendit

#nëshërbimtëqytetarëve





◀ Qarku Vlorë/Takime me nxënësit, në kuadër të programit "Siguria e të rinjve"

Raporti i ngjarjeve, 14 tetor 2025 ▶

Kërko

Enter a word for search

Q

Komisariati Dixhital

GET IT ON

Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

▾

Linqe

> [Arkiva](#)

> [Akademia e Sigurisë](#)

> [Ministria e Brendshme](#)

> [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)

> [Interpol](#)

> [Europol](#)

> [Misioni PAMECA V](#)

> [SCPA](#)

> [Projekti Trivalent](#)

Copyright © 2025 Policia e Shtetit. All rights reserved. Theme: ColorNews by ThemeGrill. Powered by WordPress.